

UNITED NATIONS
United Nations
Interim
Administration
Mission in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

KUVENDI I KOSOVËS СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

BULETINI

Tetor, 2007 Nr. 17

DEBAT I GJERË I KUVENDARËVE PËR ARSIMIN FILLOR DHE ATË TË MESËM

Shumë kërkesa e synime, por si të përmbushen ato



Këtë vit shkollor në sektorin parafillor, fillor dhe para universitar janë rreth 440 mijë nxënës, të cilët mësojnë në 1117 institucione edukativo - arsimore me rreth 27 mijë të punësuar
Strategjia e arsimit para universitar riafirmon përcaktimin tonë që të gjithë fëmijëve në Kosovë t'u ofrojmë arsimim cilësor dhe të orientuar drejt shkathhtësive, që paraqet edhe një lloj obligimi ndërkombëtar karshi politikave të proklamuar nga UNESCO
Strategjia e arsimit para universitar parasheh rritjen e buxhetit për arsimin para universitar deri në 133 milionë euro në vit brenda periudhës 2008/2012, që në varësi nga trendi i zhvillimit ekonomik përbën 4.46 deri 4.47 të bruto produktit vendor

Kuvendi do të procedojë të gjitha projektligjet që vinë nga Qeveria deri në fund të kësaj Legjislature

- U bisedua për përsheptimin e nënshkrimit nga PSSP-ja të ligjeve të miratuara prej shumë kohësh
- Të kihet kujdes me projektligjet dedikuar passtatusit të Kosovës



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha ka zhvilluar sot një takim me shefin e UNMIK-ut, Joakim Ryker, në të cilin ka biseduar për përsheptimin e nënshkrimit nga PSSP-ja të ligjeve të miratuara në Kuvendin e Kosovës dhe të cilat prej shumë kohësh gjenden në sirtarët e zyrës Ligjore të UNMIK-ut.

Zotëri Ryker theksoj se do të ketë angazhime të shtuara për nënshkrim sa më të shpejtë të atyre ligjeve që nuk kanë pengesa të shpallen, dhe shumica prej tyre janë të tilla, si dhe premtoi se do ta njoftojë Kuvendin për ndonjë ligj, për të cilin janë shprehur rezerva, fjala vjen nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, apo ndonjë mekanizëm tjetër ndërkombëtar. Ryker dhe Berisha janë pajtuar që gjatë ditëve në vazhdim shërbimet ligjore të Kuvendit dhe të UNMIK-ut të zhvillojnë takime intensive për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e ligjeve të miratuara apo në procedurë parlamentare.

Gjatë bisedës është shtruar edhe çështja e letrës së shefit të UNMIK-ut, drejtuar kryetarit të Kuvendit të Kosovës, lidhur me projektligjet nga Pakoja e Ahtisarit.

Zotëri Ryker tha se është mirënjohës që i është dhënë rasti të shpjegohet rreth kësaj letre, e cila pati bujë në media, por në të cilën nuk ka pasur ndonjë vërejtje për Kuvendin. Letra, theksoi shefi i UNMIK-ut, ishte përkujtesë që të veprohet me maturi sa u përket ligjeve që kanë të bëjnë me periudhën e passtatusit të Kosovës. Në këtë vështrim ai ka pohuar se nuk ka asgjë të keqe që projektligjet të procedohen më tutje, sepse kjo do të jetë në interes të përgatitjeve për atë fazë, por sa i përket miratimit të tyre final, ka tërhequr vëmendjen Ryker, duhet të respektohet komiza juridike në të cilën veprohet aktualisht.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, i tha z. Ryker se letrat e tilla për mosmiratim e projektligjeve, për të cilat ju tërhiqni vërejtjen, duhet t'i dërgohen sponsoruesit. Në të kundërtën, Kuvendi është i obliguar ta procedojë çdo ligj që vjen nga sponsoruesi dhe nuk e ka të drejtën ta tërheq projektligjin nga procedura, ka theksuar Berisha.

Duke biseduar për përgatitjet për zgjedhjet e nëntorit, bashkëbiseduesit janë pajtuar që të mos ketë vakum institucional deri në përfundim të kësaj Legjislature dhe fillim-it të Legjislaturës së Re.



PËRMBAJTJA:

Po hapen perspektiva evropiane për Kosovën 10

Kosova ka bërë kompromisin e saj duke pranuar Pakon e Ahtisarit dhe parimet e Grupit të Kontaktit..... 12

Minoritetet kanë vende të garantuara në legjislativin dhe ekzekutivin e vendit 15

Kundrim tradicional i barazisë gjinore në përmbajtjen e teksteve shkollore 17

U përurua biblioteka e Kuvendit në ambiente të reja 20

Redaksia:

Sherif Konjufca, Shefqet Rexhepi, Celal Ilyas, Edona Fetahu, Kimete Islami

Telefonat Kontaktues:

038\ 211 186, 038\ 211 949, 038\ 211 189, 044\ 127 821

Tel/Fax: 038 211 188

E-mail:

media@assembly-kosova.org

Web faqja:

www.assembly-kosova.org

Shumë kërkesa e synime, por si të përmbushen ato

Këtë vit shkollor në sektorin parafillor, fillor dhe para universitar janë rreth 440 mijë nxënës, të cilët mësojnë në 1117 institucione edukativo - arsimore me rreth 27 mijë të punësuar

Strategjia e arsimit para universitar riafirmon përcaktimin tonë që të gjithë fëmijëve në Kosovë t'u ofrojmë arsimim cilësor dhe të orientuar drejt shkathtësive, që paraqet edhe një lloj obligimi ndërkombëtar karshi politikave të proklamuar nga UNESCO

Strategjia e arsimit para universitar parasheh rritjen e buxhetit për arsimin para universitar deri në 133 milionë euro në vit brenda periudhës 2008/2012, që në varësi nga trendi i zhvillimit ekonomik përbën 4.46 deri 4.47 të bruto produktit vendor



Një nga temat qendrore të seancës së Kuvendit të Kosovës të 11 majit të këtij viti ishte debati për arsimin fillor dhe të mesëm. Në pajtim me rregullën 6.5 të Rregullores së punës, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të

Kosovës kishte kërkuar që Kuvendi të debatojë për këtë temë. Me qëllim të përgatitjes së këtij debati, Kryesia kishte kërkuar nga Qeveria, përkatësisht Ministria e Arsimit, që të paraqesë një informatë si material bazë për debat.

Arsimit t' i jepet vend më i rëndësishëm

Në fillim të seancës fjalën e mori propozuesi, përkatësisht deputeti **Enver Hoxhaj**. Duke iu drejtuar të

pranishmëve Enver Hoxhaj theksoi se gjendja në arsimin fillor dhe të mesëm kurrë nuk ka qenë më shqetësuese dhe më e



rëndë se sa këto tri vjetet e fundit. Deri më tash ka pasur përpjekje serioze që të kemi një reformim të sistemit arsimor. Çdo kush i ka parë reformat si një hap shumë pozitiv për Kosovën ,disa prej tyre i kanë dhënë edhe rezultatet e pritura. Një pjesë e madhe e tyre kanë mbetur aty ku kanë filluar. Kjo gjendje është pasojë e asaj se sistemi i arsimit fillor dhe të mesëm në Kosovë ka funksionuar këto tri vite të fundit sikurse Kosova të mos kishte fare Qeveri dhe Ministri të Arsimit. Për një arsye të tillë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka bërë kërkesë, që nga janari i këtij viti, ta kemi një seancë të veçantë sa i përket gjendjes në arsimin fillor edhe të mesëm.

Për më tepër një kërkesë e tillë së fundi është bërë edhe nga Sindikata e Arsimit. Komisioni për Arsim ka organizuar një dëgjim publik me Sindikatën. Ekziston transkripti dhe sipas rregullës së transkriptit duhet të jenë në dispozicion të gjithë deputetëve. Dhe më datën 10 prill po kjo sindikatë ka bërë edhe një letër të hapur , e cila është botuar në media, e cila do të duhej të ishte në dispozicion edhe të gjithë deputetëve, sa i përket gjendjes së rëndë në arsim.

Përndryshe, kur kemi debatuar për gjendjen e arsimit të lartë për më tepër se sa një vit, është vendosur në këtë Kuvend që të ketë debat për arsimin fillor dhe të mesëm. Ky ka qenë sugjerim i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Debati s'është mbajtur qe një vit ,meqë koalicioni qeverisës

nuk ka qenë i interesuar të ketë debat për arsimin fillor dhe vazhdimisht është shtyrë me argumentin se duhet të përgatitet një informatë nga Ministria e Arsimit.

Një informatë nga Ministria e Arsimit të gjithë ju e keni. Kjo informatë më tepër tregon se Ministria e Arsimit është më tepër Ministri e Mjerimit nga ajo se si janë gjërat, se sa Ministri e cila vërtet tregon se çfarë po ndodh në arsim. Për mua s'ka qenë dhe sot e kësaj dite nuk është e kuptueshme pse deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk e marrin pasqyrën e punës së Ministrisë, në të cilën prezantohen gjitha problemet që ka Ministria, po jepet një informatë e cila është shumë selektive. Për një arsye të tillë sot unë se kam ndërmend të merrem me atë se çfarë vërtet mendon Ministria e Arsimit, por më tepër me atë se si është gjendja në arsimin fillor edhe të mesëm. Kërkoj nga ju që vërtet ky debat të fokusohet në problemet kyçe që ka arsimi në Kosovë, në problemet urgjente që ka arsimi në Kosovë dhe definitivisht arsimit t'i jepet vend më i rëndësishëm, sidomos për vitet që vijnë dhe për muajt që na presin. Deri më tash kam takuar në 17 qytete të Kosovës prindër, arsimtarë, nxënës, të cilët e përshkruajnë gjendjen sipas tyre, i citoj, si shumë alarmante në arsim. Unë kur e kam ndërmend t'i reflektoj të gjitha këto, shpresoj që deputetët nga zonat dhe qytetet që vijnë do ta përshkruajnë një gjendje të tillë. Po më lejoni vetëm t'ju bëj me dije se sot ne debatojmë për 439 mijë e 445 nxënës që i ka arsimi fillor dhe i mesëm në Kosovë. Secili prej jush në mëngjes ose në mesditë e përcjell një nxënës në shkollë dhe secili prej jush në mbrëmje e ka një komunikim me nxënës se si ka kaluar në shkollë.

Unë e kam ndërmend vetëm t'i prezantoj 5 probleme kyçe në formë shumë të shkurtër ,të cilat e

përcjellin arsimin në Kosovë.

Hapësira shkollore në zvogëlim e sipër

Problemi i parë ka të bëjë me hapësirën shkollore. Hapësira shkollore në Kosovë jo vetëm që është e vogël, por është edhe në zvogëlim e sipër. Asnjëherë nuk ka pasur kushte më të vështira në disa shkolla dhe në qytete, se sa janë kushtet e këtyre viteve të fundit. Hapësira shkollore nënkupton që mësimi në shkolla fillore dhe të mesme zhvillohet me tri, katër ndërrime ,që ora zgjat 20 ose 25 minuta, që në një bankë ulen 2 deri në 3 nxënës. Nëse dikush mendon që kjo është fotografi që nuk i takon Kosovës, unë i ftoj që të shkoni ta vizitoni sot shkollën” Hasan Prishtina”në Prishtinë dhe mund ta shihni. Nëse dikush nuk beson që kjo fotografi është e Kosovës ju ftojme ata që janë nga Gjilani të shkojnë në Gjilan dhe ta shohin Shkollën Mjekësore në Gjilan se sa ndërrime gjatë ditës së sotshme i ka kjo shkollë.

Kosova sot ka 1200 shkolla. Hapësirën gjeografike të Kosovës e njohim, a nuk ka mund me të vërtetë deri sot të mendohet edhe në cilat pjesë të Kosovës ka nevojë për shkolla shtesë? Përveç kësaj, mënyra se si është shpërndarë hapësira shkollore në rrethinë të Prishtinës, ju keni shkollë e cila ndiqet nga 30 ose 40 nxënës përderisa shkollat tjera në Prishtinë janë të stërngarkuara me nxënës.

Problemi i dytë, për të cilin ju ftoj të debatojmë ka të bëjë me cilësinë e arsimit,me nivelin e diturisë, me atë se çfarë i ofrohet nxënësve, çka fiton nxënësi. Më lejohet vetëm t'ju ofrojë një citat me qëllim që ta dini se për çka është fjala: Citoj:” Natyrë quhet çdo gjë që nuk e ka bërë dora e njeriut”, “Dituria”, klasa e tretë. E krijon botëkuptimin për nxënësit që ne jetojmë në një kohë parahistorike dhe që shoqëria, në të cilën jetojmë

është e kohës parahistorike. E dini pse ndodh kjo? Kjo ndodh se tekstet shkollore shkruhen në Kosovë nga gjysma e punëtorëve që punojnë në Ministri të Arsimit dhe nga gjysma e të tjerëve të cilët janë të preferuar nga varësia. Recensionet nuk merren fare parasysh ,të cilët i bëjnë autorët. Një pjesë e madhe e teksteve shkollore, jo të gjitha , nuk shkruhen nga njerëzit që kanë autoritet shkencor dhe kulturor, të cilët ne i kemi në Kosovë dhe të cilët do të ishin në gjendje ta përmbushin një vakum të tillë. Përkundrazi, shkruhen nga njerëz, të cilët janë thjeshtë të preferuar të Ministrisë dhe aty unë s'e kam ndërmend të bëjë akuza direkte, po definitivisht ka hapësirë të mendohet për një manipulim klasik, edhe me libra, edhe me tekste shkollore.

Me qëllim që t' ju tregoj se në shkolla fillore dhe të mesme mendimi kritik, mendja e shëndoshë, analiza dhe përdorimi i trurit më tepër i takojnë së kaluarës, më lejoni vetëm t' ju jap dy fakte, të cilat nuk janë fakte të mia,por të cilat i kam nxjerrë nga Pasqyra e Ministrisë për vitin 2005/2006 dhe që është botuar në janar të 2006-ës. I pari ka të bëjë me suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2005/2006, sipas analizës së vetë Ministrisë. Përderisa në arsimin fillor deri në klasën e pestë rezultatet janë pozitive, në arsimin e ulët të mesëm dhe në arsimin e lartë rezultatet të cilat dominojnë janë ato negative. Unë ju kisha ftuar vetëm ta shihni raportin ose Pasqyrën, prej faqes 16 deri në faqen 18 dhe ju do të bindeni me grafikë se si shkolla e mesme është në krizë.

I dyti ka të bëjë me provimin e maturës dhe me rezultatit e tekstit kombëtar. Definitivisht kur e lexoni këtë raport ju e shihni që është arritur pragu i kalueshmërisë prej 40%.

Gjendja në arsim, niveli i diturisë që ofrohet në shkollën fillore dhe të mesme

Më lejoni vetëm t'ju bëj me dije që shkollat fillore dhe të mesme funksionojnë në një formë të tillë, ku komunikimi mes shkollës fillore,drejtorisë për arsim në komuna, Ministrisë së Arsimit nuk paraqet vijë vertikale. Mund të shihni raste të tilla në Prizren,në Besianë, në Klinë , në Burim.

Çështja e katërt ka të bëjë me statusin e arsimitarit. Nuk ka shkollë të suksesshme pa një lidhshmëri të mirëfilltë. Nëse doni dhe nëse dëshirojmë të kemi arsim modern, arsimtari duhet ta ketë një pozitë të definuar qartas dhe pagën. Nuk mund të ketë kualitet në arsim me paga lineare.

Problemi i pestë dhe i fundit dhe për të cilin s'kam dëshirë të ju lodhi shumë, por i cili është shumë shqetësues, ka të bëjë me braktisjen e shkollës. Nuk do ta përmendi dhunën në shkollë. Më lejoni vetëm të ju përmendi një shifër e cila përsëri nuk është shifër imja për të cilën ju duhet të informoheni si deputetë, jo ta merrni atë raport selektiv nga pasqyra e punës së Ministrisë së Arsimit botuar në janar të vitit 2006. Për vitin 2004/2005 kanë braktisur shkollën 4141 nxënës, prej tyre 47% janë meshkuj, përderisa 53% janë vajza.

Prandaj,me qëllim që të kalojmë në pjesën e sugjerimeve, më lejoni vetëm në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës të kërkoj nga ju që të përdoret gjysma e suficitit buxhetor nga viti i kaluar për ndërtimin e shkollave të reja dhe për renovimin e të vjetrave. Ne e pamë dje nga debati që kishim që 179 milion euro janë fond i pashpërndarë. Ne kërkojmë që gjysma e kësaj të shpërndahet për shkolla.

Arsimi para universitar ka kaluar nga faza emergjente në fazën zhvillimore

Duke marrë fjalën ministri i Arsimit Agim Veliu theksoi se ka disa vite që arsimi para universitar ka kaluar nga faza emer-



gjente në fazën zhvillimore, prandaj edhe përballohet me të gjitha sfidat që janë tipike për një shoqëri në tranzicion. Këtë vit shkollor në sektorin parafillor,fillor dhe para universitar kemi rreth 440 mijë nxënës, të cilët mësojnë në 1117 institucione edukativo - arsimore me rreth 27 mijë të punësuar.

Meqë gjatë këtyre 8 viteve kemi marrë një përgjegjësi të përbashkët për ndërtimin e institucioneve në Kosovë, fokusi i parë i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka qenë dhe mbetet ndërtimi i kapaciteteve menagjuese të sistemit arsimor. Në këtë drejtim i kemi kushtuar kujdes të veçantë kompletimit të infrastrukturës ligjore dhe ndërtimit të mekanizmave për jetësimin e saj. Kështu janë aprovuar një varg aktesh ligjore dhe nënligjore, ndërsa disa të tjera janë në procedurë. Edhe pse nuk vërehet ndonjë vakum legjislativ dhe arsimi është një kompetencë e transferuar prej kohe, mund të them se zgjidhjet konkrete që lidhen me statusin përfundimtar të Kosovës, e në veçanti me decentralizimin, na kufizojnë në veprimet tona dhe imponojnë një dinamikë e punë më të ngadalshme nga ajo që do të kishim dëshiruar.

Para dy javësh Qeveria e Kosovës ka miratuar strategjinë e arsimit para universitar 2007/2017, dokumentin që skicon rrugën e zhvillimit të këtij sektori në të ardhmen. Ky dokument është

rezultat i një procesi me pjesëmarrje të gjerë të ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë dhe parasheh masa konkrete dhe të afatizuara, si dhe zotime buxhetore për avancimin e arsimit para universitar në Kosovë. Tani jemi në procesin e ndërtimit të kornizës për monitorimin e vazhdueshëm të implementimit të këtij dokumenti dhe besojmë se do të jemi në gjendje ta vazhdojmë këtë proces ,duke ndërmarrë veprime korrektuese aty ku ka nevojë.

Një pjesë e masave kanë të bëjnë me sigurimin e një menaxhimi cilësor dhe efikas në sistemin e arsimit,që nënkupton angazhimin e mëtutjeshëm në hartimin e legjislacionit në harmoni me normat e Bashkimit Evropian, profesionalizimin e udhëheqjes arsimore në të gjitha nivelet përmes programeve aftësuese, ndërtimin e një infrastrukture për punimin e të dhënave në arsim, delegimin më të madh të kompetencave dhe të përgjegjësiave në nivel shkolle etj. Sigurimi i cilësisë është një fushë ku kemi punuar shumë, po ku gjykojmë se duhet bërë shumë punë për të ndërtuar një sistem të krahasueshëm me vende tjera. Kemi zhvilluar kurikula të reja për të gjitha nivelet me pjesëmarrje aktive të ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë. Kemi hapur tregun e teksteve mësimore, kemi ndërtuar sistemin e ri për edukimin e mësimdhënësve, kemi organizuar, përkrahur dhe financuar trajnime të mësimdhënësve në shërbim, kemi ndërtuar kapacitetin për organizimin e teksteve kombëtare në arsim, por nuk jemi të kënaqur me të arriturat tona.

Mendoj se mund të bëjmë më shumë në këtë drejtim, duke i kushtuar më shumë kujdes cilësisë së punës që bëjmë dhe efekteve që ajo ka në mesin e nxënësve. Për ta arritur këtë, duhet ta kuptojmë të gjithë se ndryshimet në arsim e në veçanti ato që kanë të bëjnë me cilësinë

paraqesin një proces që e karakterizon nevoja për përsëritjen e kohëpaskohshme të disa hapave reformues ,ndërsa efektet e këtij procesi shihen vetëm pas një kohe relativisht të gjatë.

Pra, duhet të mësohemi t'i rishikojmë dhe t'i plotësojmë kurikulet, tekstet mësimore, programet e trajnimit, duke ndërtuar kështu një sistem për sigurimin e cilësisë, sepse dihet ato asnjëherë nuk kanë fund, ndërsa cilësia asnjëherë nuk është e kënaqshme. Strategjia e arsimit para universitar riafirmon përcaktimin tonë që të gjithë fëmijëve në Kosovë t'u ofrojmë arsimim cilësorë dhe të orientuar drejt shkathësive, që paraqet edhe një lloj obligimi ndërkombëtar karshi politikave të proklamuar nga UNESCO.

Kushte optimale për organizimin e mësimimit në gjuhët e komuniteteve

Në Kosovë janë krijuar kushte optimale për organizimin e mësimimit në gjuhët e komuniteteve ,por këto kushte nuk shfrytëzohen nga të gjithë. Përderisa mësimi në gjuhën boshnjake dhe turke organizohet normalisht, te komuniteti serb akoma vërehet një përcaktim për të funksionuar në kuadër të një sistemi arsimor paralel të kontrolluar nga Beogradi.

Strategjia e arsimit para universitar parasheh rritjen e buxhetit për arsimin para universitar deri në 133 milionë euro në vit brenda periudhës 2008/2012, që në varësi nga trendi i zhvillimit ekonomik përbën 4.46 deri 4.47 të bruto produktit vendor.

Infrastruktura është investimi më i madh që na pret në 5 - vjeçarin vijues, ndërsa sipas kalkulimeve tona do të na kushtojë rreth 215 milionë euro, ose 88 për qind të shumës prej 245 milionë euro, që parashihet për implementimin e strategjisë së arsimit para

universitar. Nga kjo shumë synojmë që rreth 56 milionë euro të sigurohen nga donatorët, që paraqet një obligim afatgjatë për Kosovën.

Nuk mund të ketë arsim cilësor pa paga të mira dhe investime

Nimon Alimusaj tha se Grupi Par-

lamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka mirëpritur këtë debat për arsimin fillor dhe të mesëm,



sepse sferën e arsimit e konsideron si sferë me rëndësi vitale për shoqërinë kosovare në përgjithësi. Mendojmë se debati duhet të ketë synim të ngrejë përgjegjësinë dhe llogaridhënien, në një anë dhe në anën tjetër të forcojë participimin dhe përfaqësimin, të zgjerojë bazën e vendimmarrjes, duke futur në dialog të gjitha organet qeverisëse, por edhe opozitën, sepse, për gjendjen në arsim nuk janë përgjegjëse vetëm një ministri, në këtë rast Ministria e Arsimit, vetëm Qeveria, vetëm pozita, por është përgjegjëse e tërë shoqëria. Thënë shkurt dëshimet në arsim janë përgjegjësi e të gjitha subjekteve shoqërore. Unë dua të përmend vetëm nja dy shembuj drejtuar faktorëve tjerë që nuk merren me çështjen e arsimit edhe opozitës.

Do ta jap një shembull shumë absurd ,KEK-u, i cili s'ka lidhje me arsimin e që kujdeset për buxhetin e Televizionit Publik të Kosovës ngarkon të gjitha shkollat, gjithë njësorët e rrymës në shkolla edhe me pagesën për televizion e dihet se shkollat kanë nga disa njësorë elektrik e s'kanë asnjë televizion. Të rralla janë ato që kanë televizion. Opozita është e vërtetë se nuk e

mban barrën kryesore për përparimin e arsimit, por mund ta ndihmojë, siç është rasti i debateve, duke shtyrë, duke numëruar të metat, por edhe mund ta pengojë, siç është rasti me Universitetin e Prishtinës, ku opozita e mbajti peng udhëheqjen e Universitetin për disa vjet, vetëm me qëllim që të mbajë mbikëqyrjen politike mbi Universitetin. Pasi u përmend këtu çështja e drejtorëve le të përmendet rasti i Malishevës ku haptazi qeveria lokale, të cilën e udhëheq opozita nuk pranon as konkurset që i hap Ministria.

Na duket i qëlluar apeli i ministrit të Arsimit thënë para pak ditësh se është koha të punojmë së bashku, të mbledhim energjitë dhe burimet për të zhvilluar arsimin, për ta integruar sa më shpejtë Kosovën në familjen e kombeve të qytetëruara.

Për rezultatet e arritura në sferën e arsimit fillor dhe të mesëm foli ministri dhe ato nuk mund të mohohen. Madje, ato, nëse i vërejnë në raport me periudhën para vitit 1999, mund të konsiderohen të mëdha dhe inkurajuese. Madje, në disa aspekte Kosova është para disa shteteve të rajonit, siç janë Shqipëria dhe Maqedonia. Kosova është e vetmja që ka hartuar strategji shumë serioze afatmesme për arsimin para universitar, si një proces gjithëpërfshirës. Kjo strategji është shumë e mirë, por nëse nuk do të zbatohet, ajo do të mbetet vetëm një grumbull letrash. Po në anën tjetër, duke krahasuar gjendjen e arsimit në Kosovë me gjendjen e sistemeve të arsimit në botë, mund të konstatojmë se arsimit tek ne është shumë larg së dëshirueshmes.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i di rezultatet e arritura në sferën e arsimit fillor dhe të mesëm dhe përgëzon Ministrinë përkatëse për punën e bërë, por publikisht falënderon organizatat e ndryshme qeveritare, joqeveritare e

ndërkombëtare, për ndihmën e madhe materiale dhe me ekspertë që i dhanë Kosovës në këtë sferë.

Buxheti më i madh është i nevojshëm për ngritjen e buxhetit të infrastrukturës kapitale, sepse dihet se nuk mund të ketë rezultate të duhura në arsim pa hapësirë të përshtatshme, kur shkollat punojnë me 3 e 4 ndërrime. Lypset, pra një buxhet i ngritur edhe për mallra e shërbime, sepse dihet se nuk do të ketë arsim cilësor pa kabinete, laboratorë e prova e eksperimente. Me të drejtë, pra, ne konstatojmë se ligji ekzistues nuk është i mjaftueshëm pa rregullimin e infrastrukturë shkollore, pa paga më të mira për arsimtarët. E investimi në arsim është tejet i rëndësishëm. Tashmë është i njohur gjithkund konstatimi se një popull, një shtet nuk mund të ketë zhvillim ekonomik pa një arsim cilësor, e arsim cilësor nuk mund të ketë pa paga të mira, pa investime në arsim. Praktika e vendeve të tjera ka treguar se ato vende që për arsimin kanë ndarë buxhet të varfër janë pënuar, kurse ato vende të cilat nuk kanë kursyer buxhetin për shkollat siç janë: Irlanda në rend të parë, pastaj Suedia, Danimarka e tjera, pas 10 vjetëve kanë konstatuar se shkollat e tyre ishin industria më e madhe e tyre. Edhe në mënyrën e buxhetit të shkollave ka mungesa.

Një rëndësi të veçantë për arsim cilësor kanë edhe tekstet mësimore. Hulumtuesit kanë konstatuar se jo çdo herë ato janë cilësore, sepse ato hartohen turr e vrap nga disa autorë që kanë krijuar shumë herë monopol. Kjo e bën të nevojshme krijimin e mekanizmave të cilët garantojnë cilësinë e teksteve, ka edhe shumë probleme të tjera që kërkojnë qasje tjetër. Për shembull zbatimi i reformës në ngritjen e cilësisë së mësimdhënësve.

Pastaj, hartimi i Ligjit për pensionim të parakohshëm të mësimdhënësve me probleme

shëndetësore. Është vërtetuar se në shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës ka mbi 1000 arsimtarë me sëmundje të ndryshme që punojnë në shkollë dhe rrezikojnë edhe shëndetin e fëmijës, por ata nuk dalin në pension invalidor, sepse duhet t'i presin 65 vjet për t'i marrë ato 40 euro.

Sala Ahmetaj theksoi se çdo popull

që e quan veten i civilizuar, në nivelin institucional komunikon me një standard. Në shkollat tona dhe në institucionet



tjera, në emër të lirisë dhe të demokracisë së shprehjes, gjuha standarde përbuzet deri në keqardhje.

Një gjë duhet ta dimë të gjithë. Gjuha standarde së pari mësohet në shkollë. Ndihmesë të madhe mund të bëjnë edhe mediat me programe arsimore dhe argëtuese, të cilat për fat të keq nuk janë të nivelit të kënaqshëm. Prandaj, Ministria e Arsimit edhe institucionet tjera duhet të promovojnë kulturën gjuhësore si vlerë e domosdoshme për komunikim të mirë dhe të saktë.

Infrastrukturë e mirë ligjore për funksionimin e sistemit arsimor

Myrvete Dreshaj Baliu theksoi se

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë gjatë kësaj kohe ka nxjerrë një numër ligjesh themelore dhe ka krijuar një



infrastrukturë të mirë ligjore për funksionimin e sistemit arsimor.

Gjithashtu, ajo ka nxjerrë një numër të madh udhëzimesh administrative me të cilët është bërë strukturimi i brendshëm dhe janë funksionalizuar disa nga objektivat dhe kriteret rajonale evropiane të arsimit. Nëpërmjet këtyre mund të shihet se janë realizuar tre nga hapat themelorë të arsimit në Kosovë: integrimi i të gjithë minoriteteve, përveç atij serb, në sistemin arsimor të Kosovës, fillimi i reformave sipas strategjisë së arsimit afatmesëm të arsimit në Kosovë dhe tash strategjisë së arsimit para universitar dhe fillimi i rikualifikimit të mësimit në programin për aftësim pa shkëputje nga puna, i cili nëse do të arrijë të jetë një proces gjithëpërfshirës do të sjellë kreativitet të ndjeshëm të arsimit në shkollën tonë.

Mirëpo, në materialin e sjellë nga Ministria për debat nuk është bërë diferencimi i aktiviteteve të saj për lëmin e arsimit fillor dhe të mesëm. Përkundrazi, është sjellje e gjithë strategjia, sfidat dhe objektivat e Ministrisë në përgjithësi, pa diferencuar ato për temën konkrete të debatit parlamentar.

Cilat janë sfidat nëpër të cilat po kalon arsimit kosovar? Po të bëjmë një përpjekje sado të vogël që tekstin e ofruar nga Ministria dhe letrën e hapur të sindikatave ta lirojmë nga ndonjë deklaratë jo aq përmbajtjesore, nuk është vështirë të shihet se në arsimin kosovar shqetësimet janë të përbashkëta, si për institucionet qeveritare, ashtu edhe për ato joqeveritare. Nga tri kërkesat esenciale dy janë të përbashkëta, e këto kanë të bëjnë me gjendjen materiale të mësimit dhe infrastrukturën shkollore. E treta për Ministrinë është politike, integrimi i minoritetit serb, ndërsa për sindikatën kontrata kolektive.

Në vijim ajo tha se mosrealizimi i projektit për realizimin e pagave në shërbimet publike ka rrënuar

baraspeshën sociale në Kosovë. Ndërsa mësimit nënësit janë më të goditurit në këtë aspekt. Edhe zbatimi i ligjeve dhe udhëzimeve administrative paraqet sfidë më vete. Pakënaqësia e punonjësve të arsimit këtu ka një rëndësi të burimeve të përditshme. Prandaj, Grupi Parlamentar i AAK-ës sugjeron që të insistohet në zbatimin e plotë të atyre ligjeve që janë miratuar në këtë fushë.

Pse tekstet nuk po jepen falas?

Genc Gorani

përkujtoi se në ligj thuhet se shoqëria jonë nëpërmjet të kësaj Ministrie siguron tekstet për vogë-



lushët tanë prej klasës së parë deri në klasën e pestë - falas.

Në interesimin tim personal, por edhe të kolegëve të mi, se pse këto tekste më gjithë se janë falas, nuk jepen falas, përgjigja ka qenë e thjeshtë : “ S’kemi buxhet, na është refuzuar”. Kur jemi interesuar me zyrtarët të Ministrisë së Financave gjatë shqyrtimit të buxhetit ata na patën thënë se kërkesën nuk e kemi marrë fare. Më vonë e kemi kuptuar se kërkesa i është dërguar në një shumë prej diku rreth 9 milionë eurosh. Ajo që ishte çudi është se një llogari shumë e thjeshtë tregon se tekstet shkollore nuk kushtojnë më tepër se 5 milionë euro, që është një shumë relativisht modeste, duke marrë parasysh se sa është e rëndësishme. Është fjala për një masë shkollore prej 200 mijë nxënësish . Bile, është më e vogël, mirëpo neve na mungon vullneti për ta arsyetuar si duhet këtë shumë modeste për të arritur deri aty.

Deri vonë braktisja e shkollimit s’ka qenë shqetësim i rëndësishëm për ne

as në këtë Kuvend. Ndërkaq, një prej shembujve të fundit në Vullnet kishte 197 raste të braktisjes së shkollës fillore. Kur flas për Komisionin për Arsim, kemi pasur dëshirë të diskutojmë këtë çështje me zyrtarët e arsimit , veçanërisht me ministrin, ministri s’ ka ardhur. Ka pasur ftesa që janë dërguar në emër të ministrit, por ministri nuk u është përgjigjur atyre.

Për këto tri vjet, praktikisht, dy vjet e gjysmë të punës sonë, në Komisionin për Arsim, ministri është paraqitur vetëm një herë, diku rreth 10 minuta dhe pastaj ka shkuar, sepse ka pasur punë të rëndësishme. Mbyllja e klasave parashkollore arsyetohet me mungesën e buxhetit, derisa vendet fqinje i hapin këto klasa parashkollore, i gjejnë mënyrat për t’i hapur këto klasa parashkollore. Kjo është diçka që do të na kushtojë shumë shtrenjtë.

Ramadan Kelmendi shprehu

mendimin se gjendja në arsimin para universitar në Kosovë është e rëndë, por është shumë e vërtetë se në p r o c e s i n arsimor nuk



janë angazhuar shumë aq sa duhet dhe kërkohen ekspertët, të cilët këtë çështje e dinë, kanë mundësi e potencial profesional për ta avancuar. Është lehtë të konstatohet se gjendja është e rëndë, por është vështirë të jepen propozimet se si dilet nga kjo situatë, në raport me situatën edhe politike edhe ekonomike, por edhe gjendjen e lartë të papunësisë së prindërve, të cilët bëjnë çmos për t’i arsimuar dhe edukuar këta fëmijë.

Në vijim Kelmendi përmendi rastin e nga pjesa veriore e Mitrovicës ku objektet rrinë të boshatisura , sepse

atje nuk vijohet mësimi dhe nuk ka kush ta vijojë, ndërsa nxënësit tanë janë dëbuar. Ministria e Arsimit, Drejtoria e Arsimit në nivelin komunal dhe Qendra Rajonale për Arsim e Mitrovicës duhet të bëjnë çmos që vërtet t'i kthejnë nxënësit në shkollat e tyre, mirëpo në atë drejtim nuk ka organizim sa duhet dhe si duhet.

Drita Statovci shfaqti habinë se si pikërisht në kryeqytet, aty ku i kemi të grumbulluara të gjitha institucionet e mundshme të arsimit, në disa shkolla, si psh. në



shkollën "Hasan Prishtina", mësimi zhvillohet në 4 ndrrime, ndërsa për shkollat tjera të Prishtinës është fare e rëndomtë që mësimi të zhvillohet në tri ndrrime ("Naim Frashëri", Pjetër Bogdani", "Ismail Qemali", "Elena Gjika" etj.). Klasët kanë numër të madh nxënësish 30 ose 40, ndërsa hapësira ku zhvillojnë mësim, si shprehen mësimdhënësit "mezi lejon të ngopen frymë". Ora mësimore zgjatë 40 ose 30 minuta, varësisht nga ndërrimi i paradites ose i pasdites, ndërsa inventari dhe kushtet higjienike brenda shkollës nuk janë fare të lakmueshme. Ngjashëm ndodh edhe në qendra të tjera.

Gani Koci tha se në 13 shkolla fillore të Komunës së Skenderajt mungon uji i pijes, në 8 shkolla nuk ka rrymë, në 7 shkolla mësimi



zhvillohet në konteiner, në 6 shkolla nuk ka poligone sportive, fusha që duhet t'i ketë shkolla. Qe 7 vjet e këndeje nga institucionet e Qeverisë janë investuar vetëm 650 mijë euro.

Ndërsa, falë donatorëve janë rinovuar ose janë ndërtuar 13 shkolla, të cilëve ju jemi mirënjohës.

Brengos dukuria e vetëvrasjeve

Shkollat tona, **tha Ferid Agani**, duhet të jenë institucione të cilat ndihmojnë në formësimin e personaliteteve stabile psikologjike të të rinjve. Për fat të keq kjo nuk është duke ndodhur këto ditë. Një prej indikatorëve të këtyre zhvillimeve negative është dhuna e shtuar në shkolla dhe vartësia nga substanca psiko-aktive në moshë të re shkollore. Veçanërisht na brengos dukuria e vetëvrasjeve të shtuara në mesin e adoleshentëve, pra të rinjve të moshës shkollore. Sipas hulumtimit të bërë 30.1% e numrit të përgjithshëm të vetëvrasjeve në Kosovë, do të thotë 111 të rinj në periudhën 2000/2005 janë të kryera nga adoleshentët. Ky është indikator shumë serioz i çrregullimeve socio-psikologjike në shoqërinë tonë.



Numan Baliq

tha se është turp që edhe pas 8 vjetësh, fëmijët që mësojnë në gjuhën boshnjake, mos të kenë tekste të shtypura dhe ministri, i cili – po vërej se në librin e tij është duke shënuar diçka me kujdes, duhet ta shënojë edhe këtë. Pra, vitin e ardhshëm nuk do të duhej ta pritnim që nxënësit në shkollat fillore dhe të mesme, me mësim në gjuhën boshnjake, vitin e nëntë ta nisin pa tekste të botuara.



Xhezair Murati theksoi që arsimimi për të gjitha komunitetet paraqet

fundamentin themelor, para se gjithash për komunitetet pakicë. Unë do të thosha me këtë rast që pa arsimim, në kuptimin e plotë të fjalës, nuk ka as perspektivë të



ekzistimit të komuniteteve. Unë kisha bërë një lëvdatë, duke filluar nga koha e menjëhershme e pas luftës, si dhe për Qeverinë kalimtare, e cila na ka mundësuar t'i bëjmë ndryshimet, duke e konsoliduar mësimin në gjuhën boshnjake. Më pastaj, edhe të dy ministrinë, para se gjithash në mandatin e dytë, kanë bërë mjaft përpjekje për të na dalë në ndihmë dhe për të na mundësuar, siç tha ministri, për ta zhvilluar mësimin normal, e që unë këtë e kisha ndryshuar, e kisha precizuar edhe më shumë - kryesisht për mbajtjen normale të mësimin; për ç'arsye them - kryesisht, sepse ja, tash e tetë vite pas luftës, ballafaqohemi me vështirësi dhe probleme të shumta dhe unë këtu, sot, do t'i kisha numëruar vetëm disa prej tyre, që janë kryesore, që kanë rëndësi të jashtëzakonshme për ne. Çështja e parë të cilën e kisha theksuar është që tekstet shkollore mbesin edhe më tutje problem kryesor, e mos të flasim edhe për doracakët, fletushkat e ndryshme mësimore etj. Unë me këtë rast e kisha lutur ministrin dhe kabinetin e tij që ta marrin seriozisht parasysh që në mësimin në gjuhën boshnjake të bëjmë ndërrimin sipas rotacionit të drejtimeve në shkollat e mesme, sepse, po qe se këto ruhen për disa vite shkollore, atëherë do të kemi hipërprodhim të kuadrove të caktuara; po ashtu, ne në mënyrë të rregullt, i kemi bërë kërkesë Fakultetit Pedagogjik në Prizren, në mënyrë që nga viti i ardhshëm shkollor të mundësohet Katedra për Gjuhë dhe Letërsi Boshnjake, sepse nuk kemi mjaft arsimtar lëndor, nga kjo fushë, si dhe për matematikë dhe gjuhë angleze, por kjo ka të bëjë me vitin pasues shkollor.

/ vijon në faqe 18 /

Po hapen perspektiva evropiane për Kosovën

- *Vlerësohet momenti historik nëpër të cilin po kalon Kosova*
- *Tirana zyrtare është shndërruar kaheër në një avokat të fuqishëm të çështjes së Kosovës*



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, ka pritur kryetaren e Kuvendit të Shqipërisë, zonjën Jozefina Topalli, e cila shoqërohej nga deputetët Kastriot Islami, Fatos Hoxha, Besnik Bisha dhe Spiro Peçi.

Kryeparlamentari Berisha e ka njoftuar homologen e tij shqiptare, zonjën Topalli me zhvillimet në Kosovë, për proceset nëpër të cilat po kalon Kosova dhe për rolin e Kuvendit të Kosovës në këtë proces. Ai e ka falënderuar për ndihmën që kanë dhënë dhe po japin institucionet e shtetit shqiptar për çështjen e Kosovës dhe sidomos për procesin crucial të zgjidhjes së statusit të Kosovës. Tirana zyrtare është shndërruar kaheër në një avokat të fuqishëm të çështjes së Kosovës, ka thënë Berisha i cili, e ka vlerësuar lartë kohën që i kushtojnë Kosovës shtetarët shqiptarë në takimet me të huajt.

Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Jozefina Topalli, ka përshëndetur në emër të Parlamentit të Shqipërisë dhe të delegacionit të cilin e kryesonte, duke e vlerësuar këtë vizitë ndryshe nga çdo vizitë tjetër, për faktin se kjo realizohet në Kosovë dhe në një moment historik, krejt të veçantë, të lindjes së shtetit të

Kosovës. Kosova është në krye të agjendës së bashkësisë ndërkombëtare: të OKB-së, të SHBA-ve, të BE-së, të Komisionit Evropian dhe sigurisht të Shqipërisë dhe të vendeve të rajonit, ka theksuar ajo.

Jo vetëm rajoni konsideron pavarësinë e Kosovës tashmë si një çështje të konsumuar që ka mbetur vetëm të formalizohet, ka thënë zonja Topalli e cila, ka theksuar se ka mbetur shumë pak kohë deri në momentin e votimit të Rezolutës për Kosovën në KS të OKB-së. Ne realisht besojmë se me formalizimin e kësaj pavarësie Kosova së bashku me të gjitha vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe të të tërë Ballkanit, do të fillojë procesin e perspektivës evropiane, proces ky që kërkon shumë angazhime dhe shumë energji, ka Topalli, e cila ka vlerësuar maturinë dhe vendosmërinë e klasës politike të Kosovës në këtë moment historik.

Kryeparlamentarja Topalli ka theksuar se pas marrëveshjes së asocim-stabilizimit Shqipëria e pret ftesën për anëtarësim në NATO dhe zgjidhjen e statusit të Kosovës.

Në një pyetje të gazetarit, pas takimit,

se si e vlerëson kontributin e Kuvendit të Shqipërisë për çështjen e Kosovës, Berisha është shprehur se Kuvendi i Shqipërisë dhe institucionet e tjera të saj kanë një meritë të veçantë për atë ç'kanë bërë dhe ç'po bëjnë për Kosovën. Kemi ë varg fushash në të cilat duhet të bashkëpunojmë. Do të hapet një rrugë më e lehtë për komunikim dhe për zhvillim të gjithanshëm, ka theksuar Berisha.

Kuvendi i Shqipërisë e ka pasur për detyrë ta mbështes çështjen e Kosovës ka thënë zonja Topalli, e cila ka përkujtuar Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë, këtu e pesëmbëdhjetë më parë, në mbështetje të pavarësisë së Kosovës. Ndërkaq, duke u përgjigjur për mundësinë e vetos ruse në KS të OKB-së, kryeparlamentarja e Shqipërisë është shprehur se nuk beson dhe nuk gjen asnjë arsye për të menduar variantin e vetos. Ajo është shprehur optimiste se Rezoluta për Kosovën do të kalojë në Këshillin e Sigurimit. Berisha dhe Topalli janë pajtuar që dy parlamentet tona, por edhe institucione e tjera të Kosovës dhe Shqipërisë, duhet ta thellojnë bashkëpunimin.

Statusquoja në Kosovë është e paqëndrueshme

- *Bisedua për punën Kuvendit, për miratimin e ligjeve, për procesin negociator për zgjidhjen e statusit të Kosovës, për zgjedhjet e nëntorit dhe për bashkëpunimin ndërmjet Kuvendit dhe OSBE-së*
- *Çdo përpjekje për destabilizim, në këto çaste vendimtare drejt zgjidhjes së statusit, do të ishte me pasoja të mëdha*
- *Zgjedhjet e nëntorit do të jenë të suksesshme*

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, priti sot në një takim njohës, shefin e ri të OSBE-së në Kosovë, Tim Guldemann, me të cilin bisedoi për punën që po e bën Kuvendi i Kosovës për miratimin e ligjeve, për procesin negociator për zgjidhjen e statusit të Kosovës, për zgjedhjet e nëntorit dhe për bashkëpunimin ndërmjet Kuvendit dhe OSBE-së.

Duke i uruar z.Guldemann mirëseardhje në Kosovë dhe sukses në detyrën e re, në krye të Misionit të OSBE-së, kryeparlamentari Berisha e ka vlerësuar të suksesshëm bashkëpunimin e deri-

tashëm ndërmjet Kuvendit dhe OSBE-së dhe është shprehur optimist se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Shefi i ri OSBE-së në Kosovë, Tim Guldemann, konfirmoi vendosmërinë e tij për këtë bashkëpunim, duke shtuar se do të vazhdojë roli mbështetës dhe këshillëdhënës për legjislativin e vendit, pavarësisht nga roli dhe pozita e misionit të OSBE-së në Kosovën e passtatusit. Ai, ndërkaq, theksoi se misioni të cilin e udhëheq, aktualisht, është përqendruar në mbështetjen dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve të 17 nëntorit. Duke iu referuar përgatit-

jeve të bëra dhe qëndrimeve të artikuluar të institucioneve të Kosovës, shprehu bindjen e tij se zgjedhjet do të jenë të suksesshme. Kryeparlamentari Berisha theksoi se Kosova, tashmë ka përvoja në organizimin e zgjedhjeve dhe u dakordua me bashkëbiseduesin se çdo përpjekje për destabilizim, në këto çaste vendimtare drejt zgjidhjes së statusit, do të ishte me pasoja të mëdha.

Berisha ka theksuar përkushtimin e institucioneve të Kosovës për zgjidhjen e statusit, duke vlerësuar se statusquoja është e paqëndrueshme.

Në Parlamentin e Estonisë u formua grupi i miqësisë me Kosovën

Vendimi për formimin e “Grupit për Mbështetje Kosovës” është miratuar nga Parlamenti i Estonisë, në seancën e mbajtur me 27 shtator

Në Parlamentin e Estonisë u formua Grupi i Miqësisë me Kosovën, i formuluar me emërtimin zyrtar “Grupi për Mbështetje Kosovës”. Informata zyrtare ka ardhur në adresë të Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha.

Në këtë grup janë gjashtë anëtarë, ndërsa kryetar i grupit është Zoti

Hanes Astok.

Në njoftimin zyrtar, të cilin e ka nënshkruar kryetari i Parlamentit të Estonisë, Ene Ergma, njoftohet se anëtarë të Grupit të Miqësisë me Kosovën janë deputetët : Hanes Astok, kryetar i Grupit, nga Partia Reformiste, Mart Nut, nënkryetar, Andres Herkel, Jaanus

Marrandi, Jaak Salumets dhe Ester Tuikso.

Në letrën drejtuar kryeparlamentarit Berisha, bëhet e ditur se vendimi për formimin e “Grupit për Mbështetje Kosovës” është miratuar nga Parlamenti i Estonisë në seancën e mbajtur me 27 shtator.

Kosova ka bërë kompromisin e saj duke pranuar Pakon e Ahtisarit dhe parimet e Grupit të Kontaktit

- *Pavarësia e Kosovës nuk e dëmton paqen dhe stabilitetin e rajonit, përkundrazi, ajo është në të mirë të rajonit dhe të vetë Serbisë*
- *Jemi shumë të përkushtuar për integritet evropian*

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, ka pritur sot dy anëtarë të Asamblesë Nacionale të Francës: Jean-Pierre Dufau dhe Jean-Michel Ferrand, të ngarkuar për çështje të Kosovës dhe anëtarë të Komitetit për Punë të Jashtme të Asamblesë Nacionale të Francës, si dhe zyrtarë të tjerë të këtij komiteti, të cilët po qëndrojnë në Kosovë dhe rajon me qëllim të përpilimit të një raporti studiues për gjendjen në këtë pjesë të Evropës . Në këtë vështrim delegacioni parlamentar francez, i cili shoqërohej nga Thierry Reynard, shef i Zyrës Ndërlidhëse të Francës në Prishtinë, është interesuar për proceset në Kosovë drejt zgjidhjes së statusit.

Kryeparlamentari Berisha ka falënderuar për angazhimet dhe kontributin e shtetit francez për procesin në Kosovë, kurse në mënyrë të veçantë ka falënderuar Asamblesë Nacionale të Francës, e cila në mënyra të ndryshme e ka mbështetur dhe vazhdon ta mbështesë Kuvendin e Kosovës.

Duke iu përgjigjur interesimeve të parlamentarëve francezë për aktualitetin dhe perspektivat e proceseve në Kosovë, sidomos për gjasat e gjetjes së një kompromisi në bisedimet shtesë me palën serbe, Berisha ka theksuar se vendi po kalon nëpër momente vendimtare historike.

Kosova ka bërë kompromisin e saj duke pranuar Pakon e Ahtisarit dhe

parimet e Grupit të Kontaktit, ka spikatur kreu i legjislavit të vendit, duke i garantuar mysafirët se pavarësia e Kosovës nuk e dëmton paqen dhe stabilitetin e rajonit, përkundrazi, ajo është në të mirë të rajonit dhe të vetë Serbisë. Kosova e pavarur, ka thënë Berisha jep garancione të fuqishme për të gjithë qytetarët e Kosovës, sidomos për minoritetet, duke shtuar se vonimi i zgjidhjes së statusit, tashmë, është bërë pengesë e zhvillimit të vendit.

Duke përvijuar vizionin për të ardhmen e Kosovës, Berisha u ka shprehur parlamentarëve francezë dëshirën e popullit të Kosovës dhe përkushtimin e institucioneve të vendit për integritet evropian.

Çmohet lart ndihma e gjithanshme që i ka dhënë Zvicra Kosovës

Statuskuoja në Kosovë nuk është e pranueshme, prandaj të gjithë duhet të angazhohen për të gjetur një zgjidhje të statusit të Kosovës

Kryetari i Kuvendit të Kosovës , Kolë Berisha, kishte sot një takim njohës me shefin e ri të Zyrës Ndërlidhëse të Zvicrës, Lukas Beglinger. Tema bosht të këtij takimi ishin thellimi i mëtejme i bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës, sidomos në fushën e bashkëpunimit ndërparlamentar, si dhe procesi i statusit të Kosovës. Në këtë frymë kryeparlamentari Berisha e njoftoi z. Beglinger për punën që bëhet në Kuvendin e Kosovës në lëmin e legjislacionit. Ai çmoi lart ndihmën e gjithanshme që ka dhënë Zvicra , para së gjithash me përkrahjen politike të përcak-

timit të statusit të Kosovës, si edhe me projektet e shumta të realizuara në vise të ndryshme të Kosovës që kanë lehtësuar jetën e qytetarëve tanë (ujësjellës, energji elektrike etj.).

Edhe me këtë rast z. Lukas Beglinger konfirmoi gatishmërinë e Zvicrës për të vazhduar të gjitha këto projekte, ndërkaq duke folur për çështjen e statusit të Kosovës , ai tha se statuskuoja në Kosovë nuk është e pranueshme, prandaj të gjithë duhet të angazhohen për të gjetur një zgjidhje të statusit të Kosovës. Përkritazi me këtë kryeparlamentari Berisha përsëriti qën-

drimet e institucioneve të Kosovës për të ardhmen e Kosovës, sipas vullnetit të popullit për pavarësi.

Z. Lukas Beglinger gjatë këtij takimi u shpreh i bindur se Zvicra është ndër vendet që do të ofrojë mbështetje ekonomike për Kosovën. Në këtë kuadër ai theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërrajonal ekonomik, si formë më e lehtë e realizimit të investimeve në projekte të mëdha.

Në takim u folë edhe për zgjedhjet e 17 nëntorit në Kosovë. U konfirmua se në këto zgjedhje edhe Zvicra do të dërgojë vëzhguesit e vet.

Shqipëria po e bën atë që është e nevojshme dhe e mundshme në këto rrethana

- *Është biseduar për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve dhe subjekteve politike të dy vendeve, për zgjedhjet parlamentare dhe lokale në Kosovë dhe për procesin e zgjidhjes së statusit të Kosovës*
- *Vlerësohet shumë e rëndësishme ruajtja dhe forcimi i partneritetit me miqtë e Kosovës*
- *Ekipi i Unitetit është në rrugën e formalizimit të një pavarësie që sot është tërësisht në duar të shqiptarëve*

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, ka pritur sot një delegacion të Partisë Socialiste të Shqipërisë, të kryesuar nga Edi Rama, kryetar i kësaj partie.

Në takim është biseduar për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve dhe subjekteve politike të dy vendeve, për zgjedhjet parlamentare dhe lokale në Kosovë, më 17 nëntor, dhe për procesin e zgjidhjes së statusit të Kosovës.

Kryeparlamentari Berisha ka falënderuar për angazhimin e Qeverisë së Shqipërisë, të institucioneve të tjera shtetërore dhe të subjekteve relevante politike në Shqipëri për zgjidhjen e drejtë të çështjes së Kosovës. Ai theksuar se Shqipëria po e bën atë që është e nevojshme dhe e mundshme në këto rrethana, kurse e ka vlerësuar shumë të rëndësishme angazhimet e diplomacisë shqiptare për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Berisha, ndërkaq, ka shpjeguar hollësi për punën e Kuvendit të Kosovës dhe angazhimet e legjislativit të vendit në planin e miratimit të ligjeve.

Kryetari i Partisë Socialiste të Shqipërisë, Edi Rama, ka shprehur admirimin e tij për punën e Ekipit të Unitetit, veçanërisht për qasjen e duhur në drejtim të proceseve për statusin e Kosovës. Kreu i socialistëve shqiptarë ka shprehur nevojën e bashkëpunimit dhe të koordinimit të aktiviteteve në të mirë të të dy vendeve dhe të rajonit. Rama,



ndërkaq, ka theksuar se Kosova ka miq të fuqishëm në botën demokratike, prandaj e ka vlerësuar shumë të rëndësishme ruajtjen dhe forcimin e partneritetit me to. Edi Rama në takim me kryeparlamentarin Berisha ka shpalosur edhe nismat që janë bërë e po bëhen me partitë socialiste të vendeve evropiane dhe aleatet e tyre me programe të përafërta, në mënyrë që në formë rezolute të thuhet hapur dhe prerazi rëndësia e ruajtjes së Pakos së Ahtisarit në formën e dhënë.

Në takim është folur edhe për bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, me theks të veçantë bashkëpunimin në lëmin e energjetikës.

Duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve (pas takimit) rreth ideve

të hedhura për ndarjen e Kosovës, Rama është shprehur: “ Kjo është një hipotezë që nuk mund të ndodhë. Territori i Kosovës është një, i pandashëm i pacenueshëm dhe i pacopëtueshëm”.

Për tensionimet ndërmjet faktorëve ndërkombëtarë, për shkak të statusit të Kosovës, Rama është shprehur se është normale që në fund të procesit të ketë kështu momenti. Këtë proces, ka thënë Rama, populli i Kosovës e ka vendosur me një përpjekje historike; e ka vultur me luftën e tij të drejtë për pavarësi dhe me krijimin e këtij konteksti ku ndodhemi sot. Ekipi i Unitetit është në rrugën e formalizimit të një pavarësie që sot është tërësisht në duar të shqiptarëve, u ka thënë gazetarëve kreu i socialistëve shqiptarë.

Vonesa e zgjidhjes së statusit ka bllokuar proceset zhvillimore në Kosovë

Lordi Johnston këtë vizitë në Kuvendin e Kosovës e bën në kuadër të përgatitjes së një raporti që do ta paraqesë para Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kole Berisha, priti sot një delegacion të Këshillit të Evropës që kryesohej nga lordi Russell Johnston, raportues në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Në delegacion ishin edhe znj. Sonja Sirtari, nga Komiteti për çështje politike i Asamblesë Parlamentare dhe z. Zyrab Katchkatchishvilli, shef i Zyrës së Këshillit Evropian në Kosovë. Në këtë takim u bisedua për zhvillimet aktuale në Kosovë, ecuritë lidhur me procesin e statusit të Kosovës, bashkëpunimin me bashkësinë ndërkombëtare, si dhe

për angazhimet dhe rolin e Kuvendit të Kosovës në këtë proces.

Lordi Johnston këtë vizitë në Kuvendin e Kosovës e bën në kuadër të përgatitjes së një raporti që do ta paraqesë para Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

Kryetari i Kuvendit, Kole Berisha, i paraqiti mysafirit nga Këshilli i Evropës një pasqyrë të hollësishme për zhvillimet në Kosovë, për aktivitetet legislative të Kuvendit, pastaj rëndësinë e zgjidhjes sa më të shpejtë të statusit të Kosovës, si dhe rëndësinë e veçantë që ka për këtë proces angazhimi i vendosur dhe

konsensual i vendeve anëtare të BE-së. Vonesa e zgjidhjes së statusit ka bllokuar proceset zhvillimore në Kosovë, ka theksuar kryetari i Kuvendit.

Në bazë të interesimit të lordit Johnston, kryeparlamentari Berisha shpjegoi edhe shkallën e bashkëpunimit të Kuvendit të Kosovës me parlamentet e tjera evropiane, shkallën e përgatitjeve për miratimin e ligjeve që mundësojnë implementimin e Pakos së Ahtisarit, si dhe shumë çështje të tjera, të cilat do të zënë vend në raportin e lordit Russell Johnston për Kosovën.

Pala kosovare ka ofruar kontribut maksimal dhe ka bërë kompromiset e duhura në procesin negociator për statusin

- *Tani me miqtë tanë ndërkombëtarë jemi duke pritur zgjidhjen e merituar për popullin e Kosovës*
- *Pavarësinë e vendit duhet ta prisni me qetësi dhe durim*
- *Berisha u ftua ta vizitojë Parlamentin e Saksonisë së Ulët*

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, po sot priti edhe një delegacion shumanëtarësh të Parlamentit të Landit të Saksonisë së Ulët, i kryesuar nga kryetari i Parlamentit, Jürgen Gansäuer.

Duke falënderuar për pritjen zotëri Gansäuer theksoi se edhe këtë vizitë në Kosovë, si shumë të tjera deri më tash, po e bën që të njihet me këto momente vendimtare të Kosovës dhe që të ofrojë ndihmën e tij për këto procese.

Kryeparlamentari Berisha edhe në këtë rast falënderoi për ndihmën e Gjermanisë në proceset për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Ai paraqiti para delegacionit parla-

mentar të Landit të Saksonisë së Ulët një pasqyrë të punës që bëhet në Kuvendin e Kosovës dhe përgjithësisht të proceseve aktuale në Kosovë.

Duke u përqendruar në ndihmën e Gjermanisë në proceset për zgjidhjen e statusit të Kosovës, Berisha ka theksuar se pala kosovare ka ofruar maksimumin e kontributit dhe ka bërë kompromiset e duhura në negociatat për statusin. Bashkë me miqtë tanë ndërkombëtarë jemi duke pritur zgjidhjen e merituar për popullin e Kosovës, ka thënë Berisha, i cili edhe në këtë takim ka kërkuar nga bashkësia ndërkombëtare që ta

shtojë tryshninë mbi Serbinë, e cila nuk ka lëvizur nga qëndrimet fillestare.

Kryetari i Parlamentit të Saksonisë së Ulët, Jürgen Gansäuer ka shprehur bindjen e tij se populli i Kosovës, në këto momente vendimtare, pavarësinë e vendit duhet ta presë me qetësi dhe durim. Ai ndërkaq, ka mbështetur përgatitjet që bëhen në Kuvendin e Kosovës rreth Pakos së Ahtisarit. Kryeparlamentari i Saksonisë së Ulët, Gansäuer, e ka ftuar kreun e legjislavit të Kosovës, në një vizitë në Parlamentin e këtij Landi në Hanover, të cilën Berisha e ka pranuar me kënaqësi.

Minoritetet kanë vende të garantuara në legjislativin dhe ekzekutivin e vendit

- *Populli dhe institucionet e Kosovës presin nga Spanja të mbajnë qëndrim unik me vendet tjera të BE-së për pavarësinë e Kosovës*
- *Kuvendi e ka pranuar Planin e Ahtisarit me kusht që ai të pranohet nga bashkësia ndërkombëtare dhe vetëm si i tillë mund të zbatohet, duke i hapur rrugë edhe misionit të BE-së në Kosovë*
- *Serbët të dalin në zgjedhje dhe të mos e pranojnë rolin e monedhës politike të Beogradit*
- *Forcat e sigurisë në Kosovë kanë kapacitete ta mbajnë nën kontroll gjendjen, por nëse statusi zvarritet pas 10 dhjetorit mund të tensionojë rajon dhe protesta në Kosovë*

Anëtarët e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës. Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Ramë Buja, Gazmend Muhaxheri dhe Bislim Hoti kanë pritur sot ambasadorin spanjoll në Beograd, Jose Riera Siquier, me të cilin kanë biseduar për zhvillimet në Kosovë, në kontekstin e procesit për përcaktimin e statusit, të mbajtjes së zgjedhjeve të 17 nëntorit dhe të gjendjes së sigurisë tash dhe pas përfundimit të bisedimeve shtesë, më 10 dhjetor.

Duke e përshëndetur diplomatin spanjoll, anëtari i Kryesisë, Sabri Hamiti, ka theksuar punën me intensitet që bën Kuvendi i Kosovës, deri dy ditë para zgjedhjeve të 17 nëntorit, për të plotësuar orarin e miratimit të ligjeve dhe, sidomos, të mos ketë vakum institucional në Kosovë. “Zgjedhjet kemi vendosur t’i mbajmë për hir të forcimit të rendit demokratik, por ato edhe mund të mos i mbajmë fare nëse në çfarëdo mënyre ato e lëndojnë zgjidhjen e statusit të Kosovës, i cili duhet të jetë vetëm pavarësi për vendin, ka sqaruar Hamiti.

Kuvendi e ka pranuar planin e Ahtisarit me kusht që ai të pranohet nga bashkësia ndërkombëtare dhe vetëm si i tillë mund të zbatohet në Kosovë, është shprehur i prerë ai, duke pohuar se vetëm asisoji i hapet rrugë edhe misionit të BE-së në Kosovë. Ndryshe nuk ka shans, ka thënë Hamiti, i cili pavarësinë e vendit e ka quajtur kusht ekzistencial të vetëvendosjes së popullit të Kosovës.

Në interesimin e diplomati spanjoll për gjendjen e sigurisë tash dhe në per-



spektivë, pash 10 dhjetorit, anëtari tjetër i Kryesisë Xhavit Haliti, është shprehur i bindur se forcat e sigurisë në Kosovë kanë kapacitete ta mbajnë nën kontroll gjendjen, dhe e ka garantuar mysafirin se pjesëtarët NATO-s kanë kredibilitet të lartë në Kosovë. Por, nëse statusi zvarritet pas 10 dhjetorit, mund të priten tensione në rajon dhe mund të shtohet pakënaqësia e qytetarëve, e shoqëruar edhe me protesta në Kosovë, ka thënë ai.

Pyetjes së diplomatit spanjoll për gjasat që pas zgjedhjeve serbët dhe minoritet e tjera të marrin pjesë në Qeverinë e re të Kosovës, Sabri Hamiti, i është përgjigjur që zgjedhjet mbahen sipas Komizës Kushtetuese e cila rezervon 20 vende për minoritetet (10 për serbët), kurse duke dalë në zgjedhje shtohet numri i deputetëve serbë dhe shtohet legjitimiteti i tyre përfaqësues. Duke u bërë ftesë serbëve të dalin në zgjedhje dhe të mos e pranojnë rolin e monedhës politike të Beogradit, ai ka

pohuar se janë paraparë edhe vende të garantuara për minoritetet edhe në ekzekutivin e vendit.

Anëtari i Kryesisë Bislim, i cili përfaqëson minoritetin egjiptian, ka pohuar se të gjitha minoritetet mund të lëvizin lirish në gjithë territorin e Kosovës dhe se të gjitha ato, pos serbëve, e ëndërrojnë dhe angazhohen për pavarësinë e Kosovës. Hoti është shprehur i prerë se pavarësia r Kosovës duhej njohur që më 1999.

Ambasadori spanjoll në Beograd, Jose Riera Siquier, është shprehur se vendi i tij parapëlqen një zgjidhje të negociueshme nga të dyja palët dhe se si vend i BE-së është shumë i interesuar për zhvillime pozitive në këtë pjesë të Evropës.

Anëtarët e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës i kanë thënë diplomatit spanjoll se populli dhe institucionet e Kosovës presin nga Spanja të mbajnë qëndrim unik me vendet tjera të BE-së për pavarësinë e Kosovës.

Raporti parasheh krijimin e Komisionit për punë të jashtme dhe ati për Çështje evropiane

- *Themelimi i Komisionit për Integrim Evropian do të mbulojë të gjitha iniciativat e politikave dhe legjislacionit evropian në Kuvendin e Kosovës dhe, në përgjithësi, futjen e tyre në demokracinë e vendit*
- *Raporti flet edhe për krijimin në të ardhmen të Ministrisë për Punë të Jashtme dhe rrjetin diplomatik të Kosovës*



Nga Komisioni Parlamentar për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Euro-Atlantike duhet të krijohen (gjatë Legjislaturës së ardhshme) dy komisione parlamentare: Një komision për punë të jashtme, në të cilin do të zhvillohej diplomacia parlamentare në Kuvendin e Kosovës dhe një Komision parlamentar për çështje evropiane, i cili do të merrej me çështje të integritimit në BE (edhe pse ende nuk ka filluar kandidatura për anëtarësim). Ky është vlerësimi bazë i Raportit të këshilltarit për integrim evropian, Alain Barrau, raport të cilin anëtarët e Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar, nën drejtimin e Sabri Hamitit, kryetar i

komisionit, e kanë vlerësuar shumë korrekt, profesional dhe përvijues në fushën e krijimit të politikës së jashtme të Kosovës.

Themelimi i Komisionit për integrim evropian, thuhet në raport, do të mbulojë të gjitha iniciativat e politikave dhe legjislacionit evropian në Kuvendin e Kosovës dhe, në përgjithësi, futjen e tyre në demokracinë e vendit. Themelimi i këtij komisioni, vazhdon raporti, do të mundësojë (në nivel parlamentar) balancimin e dhe plotësimin e bashkërendimit të përpjekjeve të bëra, tanimë, nga Qeveria me krijimin e Agjencisë për Integrim Evropian. Raporti flet edhe për krijimin, në të ardhmen, të Ministrisë për Punë të Jashtme dhe

rrjetit diplomatik të Kosovës.

Anëtarët e Komisionit janë pajtuar se komisionet që do të formohen, pos përzgjedhjes së deputetëve me afinitet dhe përkushtim për politikë të jashtme dhe integrim evropian, duhet të kenë edhe staf përcjellës shumë profesional.

Kryetari i Komisionit, Sabri Hamiti, i ka njoftuar anëtarët e Komisionit se z. Barrau, do të vijë në Kosovë shumë shpesh për të ndihmuar në saktësimin e programit dhe përgatitjen e vazhdimeve të raportit të tij. Ai ka thënë gjithashtu se në një mbledhje të ardhshme të Komisionit do të marrë pjesë edhe do të raportojë edhe përfaqësuesi i Agjencionit për Integrim Evropian, z. Shenoll Muharremi.

Kundrim tradicional i barazisë gjinore në përmbajtjen e teksteve shkollore

Kosova për nga shkalla e përfshirjes së nxënësve dhe studentëve , ashtu si dhe për nga shkalla e të diplomuarve, sipas përqindjes së popullsisë, dukshëm është nën nivelin e shteteve të Rajonit

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport i Kuvendit të Kosovës , i kryesuar nga Enver Hoxhaj, kryetar i Komisionit, mbajti një dëgjim publik lidhur me raportet : Auditimi i çështjeve gjinore në sistemin arsimor – Qendra Kosovare për Studime Gjinore; Qeverisja dhe konkurrenca në arsimin e lartë – KIPRED dhe Raporti për rininë – UNDP. Ishte vlerësim i përgjithshëm se raportet ishin mjaft cilësore, se ato sillnin informata, vlerësime e shqetësime mbi një bazë të gjerë hulumtimesh shtruese në këto segmente të rëndësishme të shoqërisë sonë.

Vëmendje e veçantë në këtë dëgjim

publik iu kushtua perspektivës së barazisë gjinore dhe tejkallimit të paragjykimeve e tradicionalizmit në aspektin gjinor. Shih për këtë u tha se është e nevojshme hartimi i politikave nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe subjekteve të tjera për zbatimin e barazisë gjinore në të gjitha nivelet e arsimit. Vërejtje më të mëdha në adresë të një kundrimi ende tradicional në fushën e barazisë gjinore u dhanë edhe në përmbajtjen e teksteve shkollore , të cilat nuk përkojnë me kërkesat bashkëkohore në lëmin e barazisë gjinore, sidomos në aspektin e hapësirës shumë më të ngushtë që i jepet femrës në krahasim me mashkullin.

Gjatë debatit u tha se shpesh thuhet se

rinia është pasuria më e madhe e shoqërisë , por sikur harrohet të thuhet se kjo vlen vetëm nëse rina shkollohet, pra është e arsimuar. Në këtë vështrim u dhanë të dhëna se Kosova për nga shkalla e përfshirjes së nxënësve dhe studentëve , ashtu si dhe për nga shkalla e të diplomuarve, sipas përqindjes së popullsisë, dukshëm është nën nivelin e shteteve të Rajonit. U përmend fakti që në Kosovë diplomojnë katër herë më pak studentë se sa në Bullgari sipas përqindjes së popullsisë. U bënë vërejtje edhe në aspektin e cilësisë së mësimave e studimeve, që lë shumë për të dëshiruar. Si tha një diskutues, më shumë po nxjerrim reproduktues se sa mendimtarë.

KOMISIONI PËR EKONOMI, TREGTI, INDUSTRI, ENERGJETIKË, TRANSPORT DHE TELEKOMUNIKACION I KUVENDIT TË KOSOVËS, VIZITOI INSTITUTIN INKOS

Pranimi të kuadrove cilësore i jepet rëndësi vazhdimisht

Gjatë vizitës anëtarët e Komisionit vizituan Laboratori për Kualitetin e Naftës dhe të Derivateve të Naftës, ndërsa nga përfaqësuesit e këtij laboratorit janë njoftuar me punën e gjithmbarshme të tij

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion i Kuvendit të Kosovës, të cilin e kryesonte Ibush Jonuzi, kryetar i Komisionit, vizitoi sot Institutin e INKOS-it.

Në fillim të vizitës anëtarët e Komisionit në lokalet e Drejtorisë së Institutit u takuan me Bordin e Drejtorëve të INKOS-it, të cilin e kryesonte drejtori i këtij instituti z. Beqir Xhema. Në takimin e përmendur duke informuar për punën e gjithm-

barshme të Institutit, drejtori Xhema, përveç të tjerash ka theksuar se momentalisht ky institut i ka të punësuar gjithsej 96 punëtorë, prej tyre 48 janë me përgatitje superiore profesionale dhe në mënyrë të vazhdueshme i jepet rëndësi pranimit të kuadrove cilësore profesionale me rastin e punësimit në këtë institut.

Në vazhdim drejtori Xhema, pos tjerash ka theksuar se ky institut në bashkëpunim me ekspertët e Xehetarisë nga Shqipëria ka bërë hulumtimet përkritazi me rezervat e thëngjillit në Kosovë. Ky hulumtim është kryer në afat prej gjashtë muajsh dhe ka kushtuar afro 50.000 euro. Sipas këtij hulumtimi rezervat gjeologjike të thëngjillit

në Kosovë vlerësohen në gjithsej 10.090.797.594 tonë. Nga kjo shumë e gjithmbarshme deri më tani janë shfrytëzuar afro 278.972.176 tonë, kështu që për t' u shfrytëzuar në periudhën e ardhshme kanë mbetur gjithsej 9.811.870.418 tonë thëngjill. Për hulumtime të mëtejme lidhur me rezervat e thëngjillit në Kosovë sipas përllogaritjeve të Institutit në lokacione të ndryshme në Kosovë duhet të bëhen edhe afro 2.000 shpime të reja.

Gjatë vizitës anëtarët e Komisionit vizituan Laboratorin për Kontrollimin e Kualitetit të Naftës dhe të Derivateve të saj dhe nga kompetentët e këtij laboratorit janë njoftuar me punën e gjithmbarshme të Këtij laboratorit.

Nuran Malta theksoi se arsimit është segmenti më i rëndësishëm i çdo shteti dhe i çdo shoqërie. Kur flasim për Kosovën, kjo temë merr peshë



edhe më të madhe. Kjo do të thotë që ekzistenca dhe integrimi i komuniteteve ndërlidhet në esencë me segmentin e arsimit.

Që në fillim të diskutimit tim dëshiroj të theksoj që aktivitetet në planin e arsimit në gjuhët e komuniteteve, konkretisht aktivitetet në arsimimin në gjuhën turke, në nivel të Ministrisë, përkatësisht edhe të institucioneve të tjera relevante të Kosovës, janë të kënaqshme. Bie fjala, arsimimi në gjuhën turke zhvillohet në çdo nivel, orët mbahen sipas Programit arsimor të Kosovës dhe në shkolla të përbashkëta.

Ndërkaq, edhe në arsim ekzistojnë probleme që na interesojnë të gjithëve. Ndër më të rëndësishmit, vlen të përmendet infrastruktura e pakënaqshme, mungesa e mjeteve ndihmëse mësimore, pagat e pakënaqshme të kuadrit arsimor dhe të administratës etj. Janë këto probleme tonat të përbashkëta, dhe duke qenë që arsimit është një segment shumë i rëndësishëm i shoqërisë, mendojmë që është tejet e rëndësishme që sa më parë të gjenden zgjidhjet të cilat ndikojnë në cilësi, çfarë arsimit vërtetë e meriton.

Sabri Hamiti tha se tema që është vënë në rend dite mund të shikohet dyfarësh. Mund të shikohet si vështrim i problemit për një mandat, pra për një qeveri, dhe për një ministri, dhe mund të shtrohet

si temë: Arsimit si strategji e zhvillimit nacional që shkon përtej një mandati. Unë mendoj



që sot këtu është e dobishme të flasim për mandatin e një qeverie, por shumë ma e dobishme është të flasim për strategjinë e zhvillimit nacional të arsimit, që nuk lidhet as me një ministër, as me një mandat, por lidhet me një shoqëri që pretendon të krijojë arsimin me përmasat e nevojave të veta strategjike.

Arsimi te ne vitet e fundit ka kaluar në dy gjendje, nga një gjendje e mbijetesës, ku shkolla ka qenë bashkë me arsimin si rezistencë në një shkallë të organizimit, ku arsimit duhej të merrte rolin e vet themelor përtej politikës, si një veprimtari që është motor i zhvillimit të gjithë shoqërisë. Pra nga një mbijetesë te nevoja për një reformë. Reforma do kohë dhe do para, do mjete materiale. Pra reformat për kah natyra janë të shtrenjta dhe të vështira. Unë po

them që në lëmin e arsimit janë edhe më të vështira përkundër deklarimeve, sepse kjo për kah natyra është lëmi ma konservative, jo vetëm te ne, por edhe në botën tjetër përtej nesh. Edhe ajo që këtu artikullohet si reformë te ne, unë mendoj që në disa pika i ka pikat e shkëlqimit të vet dhe këtu u tha nga dy pozicionet që u drejtuan këtu. Edhe nga opozita që paraqiti kërkesën, edhe nga ministri, që ekzistojnë ato që quhen kurikule elementare dhe dokumente strategjike që s'i konteston askush. Kemi një mori ligjesh që s'mund t'i kontestojë askush, por është problem tjetër sa veprojnë ligjet.

Ramadan Musliu theksoi se është konstatim unanim dhe i palëkundshëm se arsimit është në krizë, por nuk është vetëm arsimit në krizë, është gjithë shoqëria në krizë, është në krizë se jemi në transicion, se duhet bërë ndryshime, se duhet të bëhet shteti d.m.th. çdo gjë fillohet nga e para, por nëse është diçka në krizë atëherë na obligon që të jemi sa më racional edhe të flasim aso



soji që të ndërtohet një strategji dhe një ide se si të dilet nga kriza.

Teuta Sahatqija shprehu mendimin se gjendja pas 8 vjetësh nga lufta ende nuk dallon shumë nga ajo gjendje emergjente. Kur flitet për hapësira



shkollore, çdo herë referohet në buxhet të vogël, ndërsa në të njëjtën kohë asnjëherë nuk referohet sa përpjekje janë bërë për shkurtrimin e shpenzimeve të Ministrisë. Rast i veçantë ku arsimit mbahet në kushte jashtëzakonisht të vështira është arsimit në Mitrovicën e veriut, konkretisht shkolla fillore në Kodrën e Minatorëve, shkollë kjo e cila përbëhet prej dy kontejnerëve në të cilët mësojnë nxënësit prej klasës së parë e deri në të tetën.

Vitin e kaluar, Kryeministri dhe vetë Presidenti i Kosovës premtuan ndërtimin e shkollës fillore në këtë lagje. Shkolla dhe mundësia e shkollimit në Mitrovicë nuk është vetëm arsim,

është arsye për të qëndruar dhe jetuar në Mitrovicë.

Ilaz Pireva tha se dallimi që ekziston shkolla-qytet dhe shkolla-fshat nuk është i sotshëm. Me këtë rast ai përmendi edhe përkujdesjen e mbarë shoqërisë, që duhet të ketë lidhur me fshatrat buzë kufijve, të cilat për ditë po na mbesin pa njerëz, përkatësisht po na mbesin pa nxënës, në mungesë të infrastrukturës dhe të kushteve të vështira.

Jakup Krasniqi tha se qëllimi i debatit nuk është për të bërë fushatë, por për të ndryshuar gjendjen pozitivisht në procesin e arsimit, ndryshimin e kanë për obligim ta bëjnë ata që i ekzekutojnë politikat programore të Qeverisë të propozuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. E kanë për obligim ta ekzekutojnë ata që menaxhojnë me buxhetin e Kosovës dhe me buxhetin e Kosovës menaxhojnë ata që e kanë pushtetin. Është pozita ajo që menaxhon me Kosovën, pasi menaxhon me shumicën e buxhetit të Kosovës dhe për dështimet, nuk mund të akuzohen të tjerët.

Më vjen keq që shkolla jonë sot, jo vetëm që nuk ka kapacitet për të edukuar në aspektin e dijeve, dijeve shkencore, njeriun tonë të ri, por vërtetë ka mangësi të shumta edhe në edukim. Këtu nuk u tha asnjë fjalë se nxënësit



tanë sot nuk edukohen si duhet, as me përdorimin e gjuhës shqipe, as me njohuritë që fiton për historinë, as për njohuritë kulturore, as për traditën e kulturës sonë. Shkolla jonë është shkëputur shumë nga tradita kombëtare, është shkëputur shumë nga Rilindja Kombëtare dhe si pasojë kemi akte devijonte të ngjarjeve të 2004-ës.

Zylfije Hundozi tha se buxheti i konsoliduar i Kosovës me shitjen e licencës për Operatorin e Dytë të Telefonisë Mobile është rritur për 75 milionë euro. Qeverisë i mbetet që të gjejë rrugë dhe metoda adekuate që të bindë Fondin Monetar se rrogat e punonjësve në arsim duhet të rriten, se prej kësaj varet e ardhmja jonë.

Ibush Jonuzi tha se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet të hartojë program të veçantë për nxënësit në mërgatë. Kjo pjesë e popullatës sonë ka nevojë të përkrahet nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, nga Qeveria e Kosovës me qëllim që gjeneratat e reja përmes mësimit plotësues të gjuhës shqipe të jetojnë me Kosovën edhe në mërgatë. Mërgata shqiptare ka bërë shumë për arsimin në Kosovë.

Zylfi Merxha shtori pyetjen: deri kur do të presim ne romët që të

shkollohem i në gjuhën amtare, që 8 vjet kaluan pas luftës. Ne a do të arsimohem apo jo? Në qoftë se jo e lypj përgjigjen, në qoftë se po, kur dhe qysh?



Rifat Krasniqi pohoi se botimi i librave në gjuhën turke dhe boshnjake kushton 1.450.000 euro dhe me sigurimin e kësaj shume mund të zgjidhet problemi i librave. “Ky problem z. ministër është që 7 vjet. Ne kërkojmë që ky problem të zgjidhet, asgjë tjetër nuk po kërkojmë”, tha ai.

Gjatë debatit, në të cilin morën pjesë edhe shumë diskutues të tjerë ishte konstatim i bosht se arsimit duhet të jetë prioritet kombëtar dhe të përfshihet në programin qeverisës për vitin e ardhshëm. Shumica e folësve në Parlament janë pajtuar se duhet vepruar pa vonesë për përmirësimin e kushteve për zhvillimin e arsimit, ndryshe kanë tërhequr vërejtjen deputetët, pasojat do të jenë të mëdha dhe afatgjata për Kosovën dhe qytetarët e saj. Pas përfundimit të debatit Kuvendi miratoi këto rekomandime për përmirësimin e gjendjes në arsim

1. **Arsimi të jetë prioritet i Qeverisë, si pjesë e Programit të saj qeveritar dhe e buxhetit;**
2. **Të rivlerësohen të gjitha ligjet e arsimit në Kosovë dhe të shihen pengesat për zbatimin e tyre;**
3. **Të ngritet buxheti për arsim, pagat për arsimtarë, investimet kapitale nga suficitit buxhetor i vitit 2006, si dhe të ngriten shpenzimet për mallra dhe shërbime.**



U përrua biblioteka e Kuvendit në ambiente të reja

- *Kjo ndërmarrje është mbështetur nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare dhe nga Projekti për Mbështetje të Kuvendit të Kosovës*



Në prani të deputetëve, të stafit të Kuvendit dhe të përfaqësuesve të institucioneve shkencore, arsimore e kulturore të Kosovës, u përrua sot Biblioteka e Kuvendit të Kosovës, në ambiente të reja.

Kjo ndërmarrje është mbështetur nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare dhe nga Projekti për Mbështetje të Kuvendit të Kosovës, të cilët kanë kontribuar për pajisjen e bibliotekës me literaturë shkencore dhe për përgatitjen profesionale të stafit të bibliotekës.

Kryetari i Kuvendit, Kolë Berisha, në fjalën e tij të rastit në këtë solemnitet është shprehur i lumtur që Kuvendi, prej sot, do ta ketë një ambient më të përshtatshëm për ta strehuar, për ta ruajtur, për ta kultivuar dhe për ta shfrytëzuar librin.

“Që nga dita e nesërme, deputeti i këtij Parlamenti do të ketë mundësi të kthejë në bibliotekë, ku mund të

ulet dhe të lexojë, të shkruajë apo të hulumtojë materialin që i përshtatet fushës së tij të interesimit”, ka spikatur Berisha.

Drejtori i Bibliotekës Kombëtare, Sali Bashota, themelues i së cilës është Kuvendi i Kosovës, duke përshëndetur për këtë ngjarje kulturore në Kuvend, ka theksuar se dhurata prej 200 ekzemplarësh është vetëm fillimi i mbështetjes së vazhdueshme për Bibliotekën e Kuvendit edhe në planin udhëzimeve profesionale për organizimin e punës.

Udhëheqësi i Projektit për mbështetje Kuvendit të Kosovës, Huges de Courtrivon, duke theksuar rëndësinë që ka për avancimin e punës në Kuvend dhe për demokracinë parlamentare literaturë profesionale bashkëkohore, ka përmendur librat referues që kanë ardhur nga Parlamenti Evropian dhe 1100 librat e dhuruar nga Universiteti i

Oksfordit. Ai, ndërkaq, ka premtuar se edhe në të ardhmen Projekti do të kujdeset për stërvitjen profesionale të punonjësve të bibliotekës së Kuvendit.

Kryeparlamentari Berisha duke përvijuar rritjen në të ardhmen të kësaj biblioteke, ka falënderuar të gjithë donatorët që kanë dhuruar libra dhe literaturë tjetër shkencore, në mesin e të cilëve edhe shtëpinë botuese “Anton Pashku”, e cila pak para fillimit të ceremonisë së përrimit të bibliotekës së Kuvendit kishte dërguar si dhuratë 25 tituj të saj.

Berisha i ka njoftuar të pranishmit se, falë drejtorit të Arkivit të Kosovës, z. Jusuf Osmani, me të cilin, po ashtu, kohë më parë ka nënshkruar Memorandumin e mirëkuptimit, shumë shpejt do të përrrohet ambient i ri i Arkivit të Kuvendit.

NDI i dhuron libra bibliotekës së Kuvendit të Kosovës

Materialet burimore do të sigurojnë informata parlamentare për deputetët e Kuvendit

Si pjesë e përkrahjes së vazhdueshme për Kuvendin e Kosovës, Instituti Kombëtar Demokratik për Marrëdhënie Ndërkombëtare (NDI) ia dhuroi sot disa libra bibliotekës së Kuvendit të Kosovës: Erskine May Parliamentary Practices - Praktikrat Parlamentare, Standing Orders of the House of Commons - Private Business - Rregullorja e Punës së Dhomës së Përfaqësuesve Punët Private, Standing Orders of the House of Commons - Public Business - Rregullorja e Punës së Dhomës së Përfaqësuesve - Punët Publike; Handbook of House of Lords Procedure - Doracak mbi Procedurat në Dhomën e Lordëve; si dhe Beauchesne's Parliamentary Rules & Forms - Rregullat dhe Format Parlamentare - Beauchesne's - për Dhomën e Përfaqësuesve të Kanadasë.

Dorëzimi i këtyre librave nga NDI-ja u bë në prani të kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, dhe librat e dhuruar përfshijnë praktikrat parlamentare nga parlamentet e tjera.

“Këto burime sigurojnë shembuj të praktikave parlamentare, sikurse nga ato të Dhomës së Përfaqësuesve në Parlamentin Britanik po ashtu edhe nga Parlamenti i Kanadasë. USAID dhe NDI e kanë përkrahur Kuvendin me projekte të ndryshme partneriteti në fuqizimin dhe zgjerimin e njohurisë së procedurave parlamentare”, tha Carlo Binda, drejtor i përgjithshëm i NDI-së në Kosovë.

“Ne shpresojmë që kontributet e këtyra do të ndihmojnë në fuqizimin e bibliotekës dhe shërbimeve hulumtuese për deputetët”, tha kryetari i Kuvendit të Kosovës Kolë Berisha, i cili e falënderoi NDI-në për ndihmën e vazhdueshme që është duke ia dhënë Kuvendit të Kosovës.

Programi për Fuqizimin e Legjislativit në kuadër të NDI-së siguron përkrahje për zhvillimin e Kuvendit nëpërmjet të konsultimeve të rregullta nëpërmjet të Zyrës së Këshilltarit Legjislativ, të punës me komisionet parlamentare si dhe të trajnimeve të rregullta.

NDI ka punuar në Kosovë që nga viti 1999 në zhvillimin e institucioneve demokratike dhe organeve transparente qeveritare të cilat janë përgjegjëse ndaj qytetarëve. Programet e NDI Kosovës përfshijnë programin për fuqizimin e legjislativit, programin për zhvillimin e partive politike dhe programin për pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe financohen në masë të madhe nga Populli Amerikan nëpërmjet të Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

Një delegacion i Kosovës merr pjesë në Asamblenë Parlamentare të NATO-së

Kosova është e gatshme të marrë përgjegjësitë e veta në rolin e saj si ndihmues në garantimin e sigurisë në Kosovë, rajon dhe më gjerë, theksoi z. Naim Maloku

Një delegacion i udhëhequr nga kryetari i Komisionit për Siguri të Kuvendit të Kosovës, z. Naim Maloku, në përbërje të të cilit është edhe zëvendësministri i Punëve të Brendshme, z. Dejan Janković, me ftesë të sekretariatit të Asamblesë Parlamentare të NATO-së, mori pjesë në seancën e kësaj asambleje.

Në këtë seancë diskutohen aspekte të ndryshme të sigurisë dhe çështje me interes të veçantë për NATO-në, pa lënë anash edhe Kosovën. Pas një prezantimi të thuktë nga ana e z. Nicholas White, nga diplomatët e pavarur u diskutua çështja e Kosovës dhe siguria në rajonin e Ballkanit nga parlamentarë të vendeve të ndryshme anëtarë dhe vëzhgues të NATO-së. Me këtë rast iu dha fjala edhe z. Naim Maloku si përfaqësues i Kuvendit të Kosovës dhe udhëheqës i delegacionit. Duke koinciduar me prezantimin e z. White, sidomos në aspektet e inkorporimit të minoriteteve në institucionet kosovare, z. Maloku theksoi faktin se në përbërje të delegacionit është edhe zëvendësministri, z. Janković. Ai gjithashtu shprehu nevojën e zgjidhjes së statusit dhe kalimin e pakos së Ahtisarit dhe propozimit të tij në Këshillin e Sigurimit të OKB. Z. Maloku siguroi parlamentarët se Kosova është e gatshme të kalojë nga konsumuesi i sigurisë në konsumues dhe ndihmues në garantimin e sigurisë dhe se Kosova është e gatshme të marrë përgjegjësitë e veta në rolin e saj si ndihmues në garantimin e sigurisë në Kosovë, rajon dhe më gjerë. Ai, në thirrjen e tij që të mos vonohet zgjidhja e statusit, ftoi komunitetin ndërkombëtar që të ndihmojë zhvillimin ekonomik të Kosovës, në mënyrë që ajo të jetë faktor i krijimit të një ambienti stabil dhe prosperues për rajonin.

Vlen të theksohet se Kosova pos që po merr pjesë në këtë seancë, asaj si mysafirë iu dha edhe e drejta e fjalës si vend mysafir.

Pyetje të deputetëve të bëra në seancat e Kuvendit të Kosovës, të cilat nuk morën përgjigje



Më 21.3.2007, deputeti **Ramadan Kelmendi** i ka parashtruar zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Pushtetit Lokal, z. **Lutfi Haziri** këtë pyetje:

Në mbështetje të dispozitës së nenit 26 pika 2 të rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, i bëj pyetje Qeverisë së Kosovës, duke kërkuar që të më përgjigjet me gojë në seancën e radhës së Kuvendit :

A ka ndërmarrë ndonjë veprim juridik MPL, që me ndonjë udhëzim administrativ të ndikojë në drejtoritë kompetente të kuvendeve komunale për mbrojtjen e të drejtave në punë të një numri të madh të punëtorëve në sektorin privat, të cilët po diskriminohen nga punëdhënësit lidhur me orarin e

punës ditore, javore, mujore, javës së punës pesë (5) ditore, punës pa kontratë pune, pa pushim javor, pa paga të rregullta e forma tjera të diskriminimit në punë.

Arsyetim

Shumë punëtorë punojnë tek punëdhënësit privatë pa kontrata pune, me mbi 40 orë punë në javë, pa pushim ditëve të vikendit. Pa të drejtën e pushimit vjetor, siç është përcaktuar me Ligjin Themelor të Punës dhe Kontratën e Përgjithshme Kolektive.

Më 17.4.2007, deputeti **Ramadan Kelmendi** i ka parashtruar zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Pushtetit Lokal, z. **Lutfi Haziri**, këtë pyetje:

Në mbështetje të dispozitës së nenit 26 pika 2 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, i bëj pyetje Qeverisë së Kosovës, duke kërkuar që të më përgjigjet me gojë në seancën e radhës së Kuvendit:

Çka ka ndërmarrë Ministria e Pushtetit Lokal që pranë çdo kuvendi të komunave të Kosovës, të sigurojë funksionimin e Zyrës së Deputetit, gjegjësisht, deputeteve në komunë t'iu mundësohet puna me qytetarë në zyrën e deputetit?

Përkundër kërkesave të shumta, shumë pak zyre të deputetëve janë lejuar të hapen pranë komunave nga strukturat udhëheqëse të komunave.

Më 17.7.2007, deputeti **Mazllom Kumnova** i ka parashtruar zëvendësministrit të Bujqësisë,

Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. **Tomë Hajdaraj**, këtë pyetje:
Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, në seancën e radhës së Kuvendit, shtroj këtë pyetje parlamentare për të marrë përgjigjen me gojë nga z. Tomë Hajdaraj.

Përveç dëmeve permanente në pyjet e Kosovës nga keqbërësit, për të cilat nuk keni referuar ende dhe klasifikohen si më të rënda, aktualisht gjatë verës pyjet e Kosovës rrezikohen edhe nga zjarret.

Pyes zëvendësministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural:
Si i vlerësoni gjendjen e tanishme të dëmeve nga zjarret në pyjet e Kosovës dhe cilat masa i keni ndërmarrë për të përballuar gjendjen e krijuar nga këto temperatura të larta?

Më 19.7.2007 deputeti **Nait Hasani** i ka parashtruar pyetje ministrit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, z. **Branislav Grbiq**.
Në bazë të rregullës 26 pika (2) të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës së Kuvendit të Kosovës.

Çështja: Vizita e zëvendësit të Sekretarit Gjeneral të OKB-së në Kosovë, në fshatrat e Klinës dhe në Mitrovicë, është shoqëruar edhe nga ministri Branislav Grbiq.

Pyetja: Cila është arsyeja e heqjes së tabelave të veturës zyrtare të Ministrisë së Kosovës në hyrje, në pjesën veriore të Mitrovicës dhe a është ky kufiri që ndan Kosovën dhe Serbinë sipas juve z. ministër dhe nëse jo atëherë kush ju detyroi t' i hiqni tabelat zyrtare?

Më 24.7.2007, deputeti **Hydajet Hyseni-Kaloshi**, në përputhje me rregullën 26 të Rregullores së

Kuvendit të Kosovës, i drejtoi Qeverisë dhe ministrisë përkatëse (Ministrisë për Kthim dhe Komunitete) këtë pyetje:

Si është gjendja e të shpërngulurve me dhunë nga komunat e Preshevës, Bujanovcit, Medvegjës etj., dhe çka ka bërë Qeveria, ministrinë dhe drejtorinë përkatëse për krijimin e parakushteve të nevojshme për kthimin në vatrat e tyre, si dhe në adresimin dhe zgjidhjen e problemeve të shumta me të cilat përballen ata, në vijimësi.

Më 31.8.2007, deputeti **Ramadan Kelmendi** i ka parashtruar ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, z. **Bujar Dugolli**, këtë pyetje:

Në mbështetje të dispozitës së nenit 26 pika 2 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, i bëj pyetje Qeverisë së Kosovës, duke kërkuar që të më përgjigjet me gojë në seancën e radhës së Kuvendit.

Procesi i privatizimit tani është në fazën përfundimtare. Në këtë proces një ndër kriteret ka qenë që ndërmarrja ta ruajë (vazhdojë) veprimtarinë e mëparshme dhe të punësojë një numër të caktuar të punëtorëve.

Sa ndërmarrje shoqërore (shtetërore) pas procesit të privatizimit e kanë vazhduar veprimtarinë paraprake, sa e kanë ndërruar dedikimin e veprimtarisë? Sa punëtorë janë kthyer deri më tani në vendet e punës?

Më 11.9.2007, deputeti **Fetah Berisha** iu ka drejtuar Kryeministrit të Kosovës dhe ministrisë përkatëse me këtë pyetje:

Vendi i quajtur Verrat e Llukës, ka vlera historike, ku janë mbajtur Kuvendet Kombëtare dhe Kuvendi i Pajtimit të Gjaqeve. Ky vend tashmë është shndërruar në deponi të plehrave dhe mbeturinave. Duke e ditur se Ligji për

Trashëgiminë Kulturore është aprovuar në Kuvendin e Kosovës, i cili siguron mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe historike shtrohet pyetja, se kur do të vihet nën mbrojtjen e Ligjit, vendi i Kuvendeve të mëdha Kombëtare, vendi i pajtimit të gjaqeve. Vlera jonë e trashëgimisë historike-Verrat e Llukës.

Më 10.9.2007, deputetja **Sala Berisha-Shala** i ka parashtruar ministrit për Ekonomi dhe Financa, z. **Haki Shatri**, këtë pyetje:

Në bazë të rregullës 26 (2) të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja: Ngritja e kapaciteteve njerëzore brenda institucioneve është një prioritet i qëlluar.

Pyetja: Sa po i kushton buxhetit të konsoliduar të Kosovës shkollimi i shërbyesve civil në institucionet private?

Më 10.9.2007, deputetja **Sala Berisha-Shala** i ka parashtruar zëvendësministrit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, z. **Tomë Hajdaraj**, këtë pyetje :

Në bazë të rregullës 26 (2) të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja: Zgjidhja e paqartësive rreth kompetencave në mes nivelit lokal dhe qendror shpesh bëhet përmes memorandumeve të bashkëpunimit.

Pyetja: Sa po respektohet memorandumi i nënshkruar në mes të Asociacionit të Komunave dhe ministrisë, konkretisht në mes të ministrisë dhe komunës së Drenasit?



Studentët e Institutit të Shkencave Politike të Universitetit të Vjenës gjatë vizitës në Kuvendin e Kosovës